



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E RISKUT TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Miratuar me Vendimine e Bordit nr. 110, datë 19.07.2016

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e sistemit të administrimit të riskut që krijon shoqëria administrative e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet bazuar në nenin 19, paragrafi 6, të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuara bazuar në Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar.

Neni 4

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “AMF” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sipas Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar;
2. “instrument i ri financiar” është një instrument financiar, i cili në përgjithësi lidhet me riskun e kreditit ose riskun e tregut, i cili është një investim i lejuar sipas nenit 87 të Ligjit dhe të cilin shoqëria administruese nuk e ka klasifikuar ende në asetet e SIK, por synon që ta klasifikojë dhe ta shfrytëzojë si pjesë e investimeve të SIK;
3. “ligj” është Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar;
4. “prova bazuar në të dhëna historike (back testing)” është procedura e testimit të performancës së një modeli strategjie për periudha të mëparshme;
5. “menaxheri i portofolit” është punonjësi i shoqërisë administruese, i cili ka si funksion të tij administrimin e investimeve të SIK;
6. “prova e rezistencës” është një teknikë simulimi që përdoret për portofolet e aseteve dhe të detyrimeve për të përcaktuar ndikimin në to në raport me gjendje të ndryshme financiare. Provat janë modele simulimi që testojnë reagimin sipas skenarëve hipotetikë;
7. “risku i kapitalit” është risku i humbjes nga ndryshimet e çmimit të instrumenteve të kapitalit dhe efekti i tyre në vlerën e asetit të një SIK;
8. “risku i kreditit” është risku i humbjes nga pamundësia që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e aseteve të SIK, të përmbushë pjesërisht apo plotësisht detyrimet e tij sipas kushteve të pranuar;
9. “risku i kursit të këmbimit valutor” është risku i humbjes nga ndryshimet e kurseve të këmbimit dhe efekti i tyre në vlerën e aseteve të SIK, në rast se asetet e SIK investohen në një monedhë të ndryshme nga monedha e përdorur për të llogaritur kthimin nga investimi;
10. “risku i palës tjetër ose palës së lidhur” është risku që lind nga mos përmbushja e detyrimeve kontraktuale nga pala tjetër ose pala e lidhur e shoqërisë administruese;
11. “risku i likuiditetit” është risku i humbjes kur një pozicion aseti në portofolin e fondit nuk mund të shitet, likuidohet apo mbyllet me kosto sa më të ulët brenda një harku kohor mjaftueshmërisht të shkurtër, duke vënë në rrezik në këtë mënyrë aftësinë e fondit për të përmbushur detyrimet e tij për shlyerje, të përcaktuara në prospekt;

12. “risku i përqendrimit” është risku i humbjes nga përqendrimi i aseteve të SIK ose në një emetues, në një grup emetuesish që janë palë të lidhura, në emetues që janë në një zonë të caktuar gjeografike, apo në emetues që përfshihen në një sektor të caktuar të ekonomisë;
13. “risku i shlyerjes” është risku i humbjes kur një transaksion për një aset të SIK nuk mund të shlyhet në përputhje me kushtet e pranuar;
14. “risku i ngjarjes” është risku i humbjes nga rrethana të paparashikueshme që shkaktojnë rënien e vlerës së tregut të një instrumenti financiar në mënyrë të menjëhershme ose të papritur në krahasim me sjelljen e tregut në përgjithësi dhe në një mënyrë që tejkalon shkallën normale të luhatjeve në vlerën e tregut;
15. “risku i normave të interesit” është risku i humbjes nga luhatjet e normave të interesit dhe efekti i tyre në vlerën e asetit të SIK;
16. “risku i tregut” është risku i humbjes nga luhatjet në vlerën e tregut të pozicioneve të portofolit të SIK që lidhen me ndryshimet në variablat e tregut, siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, çmimet e aksioneve dhe të mallrave apo klasifikimi i rrezikut të kreditit të emetuesit;
17. “risku i vendit” është risku i humbjes kur një autoritet perkatës apo bankë qendrore e një vendi, që nuk mund të përmbushë ose pritët të mospërmbushë detyrimet kundrejt subjekteve jorezidente, si dhe kur debitorët e tjerë, rezidentë të atij vendi dhe për shkak të rezidencës së tyre, nuk mund të përmbushin detyrimet e tyre kundrejt subjekteve jorezidente;
18. “risku operacional” është risku i humbjes nga procedura të brendshme të papërshtatshme dhe nga mosfunksionimi në lidhje me sistemet dhe stafin e shoqërisë administruese ose palës së lidhur e cila kryen disa funksione të deleguara për shoqërinë administruese, ose që rezulton nga ngjarje të jashtme dhe që përfshin risqe ligjore, risqe dokumentacioni dhe risqe që rezultojnë nga procedurat e tregimit, shlyerjes dhe vlerësimit, të cilat zbatohen nga SIK;
19. “SIK” është sipërmarrja e investimeve kolektive e themeluar në mbështetje të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar.
20. “zbutja e riskut” është procedura që përdoret nga shoqëria administruese gjatë administrimit të aseteve të SIK për të reduktuar risqet, në përputhje me profilin e riskut.

Neni 5

Sistemi i administrimit të riskut

Shoqëria administruese krijon dhe zbaton një sistem për administrimin e riskut i cili përfshin të gjitha procedurat që lidhen me administrimin e risqeve të përkufizuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, si dhe risqeve të tjera që ajo ndesh gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj. Sistemi i administrimit të riskut kryesisht konsiston në:

- a) Zhvillimin e strategjisë dhe politikave të shkruara, të përshtatshme dhe të miratuara nga Këshilli i Administrimit, në lidhje me administrimin e riskut siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj rregulloreje;

- b) Organizimin dhe ndarjen e përgjegjësiave gjatë administrimit të riskut që duhet të jenë proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të shoqërisë administruese dhe të SIK që administron, si dhe në zbatim të strategjisë dhe politikave të miratuara për administrimin e riskut;
- c) Dhënien e informacionit për administrimin e riskut dhe kërkesat për paraqitjen, përmbajtjen dhe shpeshhtësinë e raporteve, siç përcaktohet në nenin 8 të kësaj rregulloreje;
- ç) Krijimin e planeve të rimëkëmbjes dhe të vijueshmërisë, të përshtatshme për administrim të krizave, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë dhe çdo SIK që administron.
- d) Krijimin e një sistemi të përshtatshëm për kryerjen e transaksioneve;
- dh) Krijimin e një sistemi për implementimin e instrumenteve të reja financiare si pjesë e administrimit të investimeve të SIK, siç përcaktohet në nenin 10 të kësaj rregulloreje;
- e) identifikimin, teknikat e matjes, monitorimin dhe zbutjen e risqeve të portofolit të SIK, duke përfshirë sa më poshtë:
 - i. Metodatat e specifikuara për identifikimin e risqeve;
 - ii. Metodatat e specifikuara për matjen e risqeve përkatëse në përputhje me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të shoqërisë administruese dhe të SIK që administron. Metoda e përzgjedhur për matjen e riskut, nuk mund të ndryshohet pa arsye;
 - iii. Metodatat e specifikuara për vendosjen e limiteve dhe monitorimin e risqeve;
 - iv. Procedurat e specifikuara për zbutjen e riskut.
- ë) Hartimin e procedurave të nevojshme, për shqyrtimin rregullisht të sistemit të administrimit të riskut, për të kryer në kohë përshtatjet dhe përmirësimet e nevojshme;
- f) Përshtatjen e tij me mekanizmin e kontrollit të brendshëm, siç përcaktohet në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Strategjia dhe politikat e administrimit të riskut

1. Shoqëria administruese, në politikat dhe strategjinë saj të administrimit të riskut, përcakton qëllimet dhe parimet kryesore të përdorura gjatë administrimit të risqeve me të cilat përballen investitorët në SIK duke përfshirë minimalisht:

- a) Përcaktimin dhe formulimin sa më të saktë të risqeve që janë pjesë e sistemit të administrimit të riskut;
 - b) Objektivat në lidhje me ekspozimin ndaj risqeve të përcaktuara nga shoqëria administruese për çdo SIK në përputhje me profilet e tyre të riskut, të cilat duhet të përmbajnë:
 - i. Shkallën e pranueshme të riskut;
 - ii. Pasojat e pritshme që rezultojnë nga ekspozimi ndaj shkallës së pranueshme të riskut.
 - c) Parimet dhe metodat për identifikimin e risqeve në mënyrë të vazhdueshme;
 - ç) Procedurat dhe instrumentet që mundësojnë matjen e duhur të risqeve;
 - d) Shpërndarjen e roleve dhe përgjegjësi ndërmjet strukturave përgjegjëse për sistemin e administrimit të riskut në shoqërinë administruese;
 - dh) Kushtet e ndërveprimit ndërmjet njësisë së administrimit të riskut dhe njësisë së menaxhimit të investimeve për të mbajtur nën kontroll profilin e riskut të SIK në përputhje me strategjinë e investimit;
 - e) Kushtet, përmbajtjen dhe shpeshtësinë e raporteve mbi performancën e njësisë së administrimit të riskut që i paraqiten Administratorëve dhe Këshillit të Administrimit;
 - ë) Limitet që shoqëria administruese zbaton dhe parimet për për zgjedhjen dhe përcaktimin e tyre;
 - f) Parimet për klasifikimin dhe përdorimin e instrumenteve të reja financiare, siç përcaktohet në nenin 10 të kësaj rregulloreje;
2. Shoqëria administruese shqyrton dhe miraton strategjinë dhe politikat për administrimin e riskut në formën e një rregulloreje të brendshme të veçantë, ose si pjesë e rregulloreve të brendshme të tjera, të cilat identifikojnë në mënyrë të qartë detyrat për administrimin e riskut, përgjegjësitë dhe procedurat operacionale.
3. Shoqëria administruese shqyrton të paktën një herë në vit dhe depoziton në AMF strategjinë dhe politikat për administrimin e riskut, brenda muajit janar të çdo viti, dhe sa herë që konstatohen ndryshime në to.

Neni 7

Organizimi dhe ndarja e përgjegjësi gjatë administrimit të riskut

1. Shoqëria administruese në organizimin dhe ndarjen e përgjegjësi gjatë administrimit të riskut përfshin:

a) Krijimin e një njësie të veçantë për administrimin e riskut në strukturën organizative të shoqërisë, e cila informon rregullisht administratorët e shoqërisë administruese, të paktën një herë në muaj. Kjo njësi gjithashtu i paraqet Këshillit të Administrimit një raport për zbatimin e detyrave të njësisë së administrimit të riskut, të paktën një herë në 3 muaj;

b) Ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi të njësisë së administrimit të riskut të shoqërisë administruese dhe të stafit të saj në nivel organizativ dhe në nivel personeli, të përshtatshme për natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të shoqërisë administruese dhe të SIK që administron, për të parandaluar konfliktet e interesit;

c) Garantimin e burimeve të duhura e të nevojshme për zbatimin e strategjisë dhe politikave të miratuara për administrimin e riskut, në mënyrë të veçantë burimet financiare dhe personelin përgjegjës për kryerjen e funksionit të administrimit të riskut, me aftësitë, njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të përmbushur detyrat që u janë dhënë atyre, ashtu siç përkufizohet në Ligj dhe duke siguruar në çdo kohë zëvendësimin e tyre;

ç) Politika motivuese për stafin përgjegjës për kryerjen e funksioneve të administrimit të riskut;

d) Vënien në dispozicion të informacionit të duhur nga njësia e administrimit të riskut tek njësitë e tjera organizative të shoqërisë administruese, siç përcaktohet në nenin 8 të kësaj rregulloreje;

dh) Vendorsjen e kanaleve të rregullta të komunikimit ndërmjet njësisë së administrimit të riskut dhe menaxherëve të portofolit, me qëllim funksionimin efikas të sistemit të administrimit të riskut. Menaxherët e portofolit janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për investimet në përputhje me limitet e risqeve. Njësia e administrimit të riskut është përgjegjëse për matjen e risqeve dhe monitorimin e limiteve të tyre;

e) Garantimin që strategjia dhe politikat për administrimin e riskut njihen dhe zbatohen nga të gjitha nivelet dhe strukturat e shoqërisë administruese;

2. Shoqëria administruese garanton që ndarja e funksioneve të menaxhimit të investimeve dhe të administrimit të riskut të jetë e qartë dhe të zbatohet në të gjitha nivelet drejtuese.

Neni 8

Dhënia e informacionit për administrimin e riskut dhe kërkesat për raportim

1. Njësia e administrimit të riskut i jep informacion të plotë 1 herë në muaj Administratorëve dhe Këshillit të Administrimit në lidhje me analizën e risqeve ndaj të cilave SIK është ekspozuar. Monedha në të cilën mbahen asetet dhe detajimi i informacioneve të tjera duhet të mundësojnë administrimin efikas të risqeve, që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme performancën dhe rezultatet e SIK. Informacionet e dhëna duhet të përfshijnë:

- a) Vlerësimin e nivelit dhe të trendit në zhvillimin e riskut;
- b) Krahasimin e risqeve me rezultatet e tyre të përcaktuara nga shoqëria;
- c) Verifikimin nëse niveli i riskut është në përputhje me limitet e brendshme, aty ku aplikohet;
- ç) Vlerësimin e vlefshmërisë, përshtatshmërisë dhe përmbushjes së supozimeve të përdorura në matjen e riskut, aty ku aplikohet;
- d) Vlerësimin e rezultateve të “provave të rezistencës” dhe të “back testing”.

2. Stafit përgjegjës për kryerjen e funksioneve të administrimit të riskut duhet të ketë akses në informacion të përditësuar dhe të besueshëm në lidhje me administrimin e riskut.

3. Shoqëria administruese siguron vendosjen e kanaleve të rregullta të komunikimit ndërmjet stafit përgjegjës për kryerjen e funksioneve të administrimit të riskut dhe njësive të tjera të shoqërisë administruese, kryesisht ndërmjet stafit përgjegjës për kryerjen e funksionit të menaxhimit të investimeve dhe Administratorëve.

4. Këshilli i Administrimit pasi vlerëson informacionet në lidhje me nivelet e riskut, vijon me informimin e stafit përgjegjës për kryerjen e funksioneve të administrimit të riskut, si dhe njësive të tjera të shoqërisë administruese.

5. Shoqëria administruese raporton në Autoritet, sa herë që evidenton tejkalimin e limiteve të përcaktuara në shkronjën c, të pikës 1 të këtij neni. Autoriteti, kur e vlerëson të nevojshme mund t'i kërkojë shoqërisë administruese rishikimin e limiteve të brendshme të caktuara nga shoqëria administruese.

Neni 9

Zbutja e risqeve kryesore

1. Shoqëria administruese veçanërisht zbut risqet kryesore, të cilat janë: risku i kreditit, risku i tregut, risku operacional dhe risku i likuiditetit.

2. Shoqëria administruese për të zbutur riskun e kreditit të SIK ndërmerr veprimet e mëposhtme:

a) Miraton limite të brendshme të ekspozimit ndaj riskut të kreditit të SIK sipas profileve të miratuara të riskut dhe verifikon përputhshmërinë me këto limite të brendshme;

b) Miraton limite të brendshme të veçanta për palët e tjera për transaksionet në tregjet mbi banak (OTC) për derivativët financiarë dhe miraton kushte në rastet e marrjes dhe dhënies së kolateralit për kreditin ose debitin e një portofoli të SIK dhe verifikon përputhshmërinë me limitet e brendshme të caktuara;

c) Vlerëson situatën ekonomike të emetuesve të titujve të mbajtura nga SIK dhe të palëve të tjera të derivativëve financiarë në tregjet mbi banak (OTC);

ç) Miraton metodat dhe procedurat për administrimin e riskut të kreditit;

d) Identifikon, mat, monitoron dhe zbut riskun e kreditit;

dh) Përpunon dhe jep informacion mbi riskun e kreditit për qëllime të administrimit të këtij risku dhe të proceseve vendimmarrëse të shoqërisë administruese.

3. Shoqëria administruese për të zbutur riskun e tregut ndërmerr veprimet e mëposhtme:

a) Miraton limite të brendshme të ekspozimit ndaj riskut të kreditit të SIK në përputhje me profilet e riskut të miratuara, si dhe verifikon përputhshmërinë me këto limite të brendshme;

b) Miraton metoda dhe procedura për administrimin e riskut të tregut;

c) Miraton metoda, procedura dhe modele për vlerësimin e pozicioneve që rezultojnë në shfaqjen e riskut të tregut;

ç) Vlerëson pozicionet që rezultojnë në shfaqjen e riskut të tregut;

d) Identifikon, mat, monitoron dhe zbut riskun e tregut;

dh) Përpunon dhe jep informacion mbi administrimin e riskut të tregut dhe proceset vendimmarrëse të shoqërisë administruese.

4. Shoqëria administruese për të zbutur riskun operacional ndërmerr veprimet e mëposhtme:

- a) Miraton metoda dhe procedura për administrimin e riskut operacional;
 - b) Identifikon, vlerëson dhe monitoron riskun operacional;
 - c) Klasifikon ngjarjet e riskut operacional;
 - ç) Merr masa për të minimizuar riskun operacional, përpunon dhe jep informacion mbi riskun operacional për qëllime administrimi dhe vendimmarrjeje.
5. Shoqëria administruese për të zbutur riskun e likuiditetit zbaton kërkesat e rregullores nr. 45, datë 30.06.2015 “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve”.
6. Shoqëria administruese, krahas risqeve kryesore të mësipërme, ndërmerr veprimet e nevojshme për zbutjen e të gjitha risqeve të tjera, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Instrumente të reja financiare

Shoqëria administruese për qëllime të administrimit të riskut, përfshin në procedurat për miratimin, klasifikimin dhe përdorimin e instrumenteve të reja financiare si pjesë e administrimit të investimeve të SIK, sa më poshtë:

- a) Përshkrimin e instrumentit të ri financiar dhe veprimeve që lidhen me të;
- b) Identifikimin e faktorëve të riskut që lidhen me instrumentin financiar;
- c) Analizën e ndikimit të instrumentit financiar të propozuar mbi portofolin e SIK;
- ç) Zbatimin e procedurave që përdoren për matjen, monitorimin dhe auditimin e risqeve që lidhen me instrumentin e propozuar financiar;
- d) Vlerësimin e nivelit të përgatitjes së njësive të veçanta të shoqërisë administruese për implementimin e instrumenteve të reja financiare.

Neni 11

Sistemi i kontrollit të brendshëm

1. Shoqëria administruese përshtat sistemin e kontrollit të brendshëm në përputhje me kërkesat e sistemit të administrimit të riskut duke:

- a) Krijuar një mjedis të përshtatshëm auditimi të performancës së aktiviteteve të shoqërisë administruese, veçanërisht:

- i. Aktivitetet dhe mekanizmat e kontrollit të kryera nga Këshilli i Administrimit dhe Administratorët;
 - ii. Aktivitetet dhe mekanizmat e kontrollit të kryera nga stafi i shoqërisë administruese në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.
- b) Verifikuar rregullisht funksionimin e sistemit të administrimit të riskut nga ana e auditit të brendshëm të shoqërisë administruese, si dhe duke vlerësuar efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
2. Sistemi i kontrollit të brendshëm të shoqërisë administruese pas gjetjeve të mangësive në lidhje me administrimin e riskut duhet:
- a) Të informojë njësitë kompetente dhe stafin drejtues mbi gjetjet e konstatuara lidhur me sistemin e administrimit të riskut të shoqërisë administruese;
 - b) Të përfshijë në raport rekomandimet në lidhje me korrigjimin e gjetjeve të konstatuara;
 - c) Të propozojë përshtatjet e nevojshme dhe në kohë të sistemit të administrimit të riskut.
3. Shoqëria administruese depoziton në AMF raportin vjetor të kontrollit të brendshëm në lidhje me sistemin e administrimit të riskut, brenda muajit janar të çdo viti pasardhës.

Neni 12

Dispozita kalimtare

Shoqëritë administruese të SIK të licencuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje duhet të marrin masat e nevojshme që të përshtasin veprimtarinë dhe rregullat e tyre të brendshme me kërkesat e kësaj rregulloreje, si dhe të depozitojnë në AMF dokumentacionin mbështetës 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.